THE LEXICON IN THE ARBANASI-CROATIAN DICTIONARIES OF KRUNO KRSTIĆ (1987) AND MAKSIMILJANA BARANČIĆ (2021): A COMPARATIVE ANALYSIS

LEKSIKU NË FJALORËT ARBNISHT–KROATISHT TË KRUNO KRSTIĆ (1987) DHE MAKSIMILJANA BARANČIĆ (2021): NJË ANALIZË KRAHASUESE

Vilma PROKO

*Center for Arbëresh Studies and Publications, Tirana, Albania
prokovilma@yahoo.com

Abstract

This paper presents a comparative analysis of how literary vocabulary is represented in the two most significant dictionaries of the Arbënesh dialect of Zadar: *Rječnik Govora Zadarskih Arbanasa/Fjalori i të folmes së arbëneshëve të Zarës (Dictionary of the Speech of the Zadar* Arbënesh*)* by Kruno Krstić (1987) and *Arbanasa–Kroatski Rječnik/Fjalor arbënesh-kroatisht [Arbënesh–Croatian Dictionary*) by Maksimiljana Barančić (2021). Both works represent a major contribution to the documentation, preservation and revitalization of the linguistic heritage of the Arbanasi in Zadar, Croatia. They are the result of decades of linguistic research and fieldwork aimed at recording the living speech of the Arbanasi community, a historic Albanian-speaking minority whose language has been profoundly shaped by centuries of contact with Croatian and Italian.
Employing a comparative lexicological and sociolinguistic approach, this study examines thematic fields, the structure of the literary lexicon, and terminology related to urban, family, cultural and administrative life.The findings show that Krstić's Dictionary (1987) preserves more strongly the archaic character and traditional lexical heritage of Arbanasi, while Barančić's Dictionary (2021) reflects a more contemporary stage of the idiom. It documents both traditional and modern usage, with a marked presence of functional Croatisms and Italianisms, loanwords and innovations characteristic of present-day Arbanasi communication.Based on an extensive corpus of everyday speech and oral tradition, Barančić's Dictionary preserves lexical, grammatical and phraseological features of the dialect and serves as a valuable resource for researchers, educators and community members engaged in maintaining this endangered variety. Overall, the two dictionaries offer an important temporal snapshot of language change and reflect broader processes of language contact, bilingualism and cultural adaptation.

Keywords: *Arbënesh, dictionary, language preservation, bilingualism, endangered dialects, cultural heritage.*

Rënia në dorë e dy veprave më të rëndësishme leksikografike të të folmes Arbëreshe të enklavës së vogël të Zarës (Kroaci), në përmbajtje të së cilave pasqyrohet visari leksikor i këtij areali gjuhësor dialektor, ka nxitur kureshtjen tonë gjuhësore për t'u njohur dhe për të ndërmarrë studime në fushë të leksikut edhe nga këndvështrimi i leksikografibërjes; rezultati i të cilit mund të vijë në ndihmë sa në truall të gjuhësisë historike krahasuese ashtu edhe në analizimin e dinamikave sociolinguistike. Ky studim, por edhe të tjerë, që do të ndërmerren në të ardhmen, do të synojnë identifikimin më së miri të koleksionit të pasur leksikor të përbërë nga fjalëforma, thënie, shprehje frazeologjike, fjalë të urta të arealit gjuhësor-dialektor të Zarës, që ka funksionuar e funksionon si mbidialekt i shqipes.
Qëllimi i punimit tonë është të ofrojë një analizë krahasuese të leksikut të paraqitur në dy fjalorët më të rëndësishëm të dialektit Arbëresh të Zarës, përkatësisht nga veprat leksikografike a. *Fjalor i të folmes Arbëresh të Zarës* hartuar nga Kruno Krstić (1987) dhe b. *Fjalor Arbëresh-Kroatisht i* hartuar nga Maximiljana Barančić (2021). Në këtë studim, të dy veprat leksikografike shihen si vijimësi të njëra tjetrës lidhur kjo edhe me kohën dhe qëllimin e hartimit të veprave dhe jetën e gjuhës së folur të kësaj pakice gjuhësore; pasi këto vepra janë një kontribut i rëndësishëm në dokumentimin, ruajtjen dhe ringjalljen e trashëgimisë gjuhësore Arbëreshe të Zarës, Kroaci. Veprat kanë ardhur si produkt nga dekada kërkimesh gjuhësore dhe pune në terren, gjë që dëshmojnë situatën gjuhësore sa aktuale, bashkëkohore po ashtu

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp117

edhe atë historike, përkatësisht nga fillimi i shekullit të 18[të] ; kohë që shënon dhe shkëputjen e këtij varianti gjuhësor-dialektor "Arbëresh" nga trungu i gjuhës mëmë e deri në ditët e sotme. Pasqyrimi i leksikut me zhvillimet e fundit sa bashkëkohore, por edhe fondit të fjalëve nga tradita "folklorike", lidhet drejtpërdrejt me kontributin e vyer të autores M. Barančić, në veprën leksikografike *Fjalor Arbërisht-Kroatisht* (2021). Në vija të përgjithshme ky leksik u trajtua në kumtesën *Leksiku libror në të dy fjalorët arbnisht-kroatisht të Kruno Krstić (1987) dhe Maximiljana Barančić (2021): Një vështrim përqasës* (*The Literary Lexicon in the two Arbanasi–Croatian Dictionaries of Kruno Krstić (1987) and Maximiljana Barančić (2021): A Comparative Approach*)[1], e përgatitur me kolegen terminologe Juliana Kume nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e mbajtur në Konferencën Shkencore "Arbanasi – Identiteti, Kultura dhe Kontributi i Komunitetit" ("Arbanasi - Identitet, Kultura i Doprinos Zajednice"), organizuar nga Universiteti i Zarës në Kroaci më 20 tetor 2026. Meqë analiza e studimit tonë fokusohet tek leksiku i të folmes arbëreshe të Zarës nëpërmjet pasqyrimit të tij në dy veprat kryesore leksikografike të kësaj të folme, nuk mund të mos pjetë pjesë përbërese e këtij punimi tonë klasifikimi i disa prej njësive sipas fushave kryesore semantike ose tematike ku rreh më fort apo gjen përdorim ky korpus leksikor.

Struktura leksikografike e veprave

Në këtë punim, mbështetur në dy veprat kryesore leksikografike të të folmes Arbëreshe të Zarës, studimi ynë merr për bazë krahasim leksikun e disa shkronjave të para të këtyre veprave, për të dëshmuar nëpërmjet analizës ballafaquese evidentimin e disa tipareve të veçanta dhe të përbashkëta të korpusit leksikor themelor të këtij areali gjuhësor-dialektor.

Lidhur me *Makrostrukturën* e veprave duhet nënvizuar se ngërthejnë elementët bazë që ngrejnë, mbajnë dhe formësojnë informacionin gjuhësor të të folmes së Zarës, pra listën e plotë të fjalëve hyrëse – tërsisë së lemave kryesisht të ligjërimit të përditshëm të komunitetit përkatës gjuhësor, me qëllim pasqyrimin e pasurisë leksikore të trashëguar dhe atë të fituar ndër vite në truallin e ri.

Secila prej veprave leksikografike në makrostrukturën e tyre, sipas qëllimit përkatës, ngërthejnë njësi leksikore arkaike të kësaj të folme (kur i referohemi Fjalorit K. Krstić), pra përshkrimin e plotë leksikor të kësaj të folme në harkun kohor, që nga momenti i shkëputjes nga gjuha e origjinës deri në botimin e veprës, viti 2009 (rreth 5000 lema, shprehje frazeologjike e thënie të kësaj të folme, në një volum prej 312 faqesh). Ndërkaq, si vazhdimësi e punës leksikografike, për evidentimin e pasurisë dhe gjendjes leksikore të kësaj të folmeje në ditët e sotme, vijon Fjalori i M. Barančić (rreth ... lema, në një volum prej 157 faqesh), i cili sipas një pikëprerje sinkronike shpërfaq vlera sa ruajtëse, që kanë mbijetuar në këtë të folme, po aq edhe inovative të "risive leksikore" të kësaj të folme, si produkt i marrëdhënie komplekse sociolinguistike. Pra, kjo vepër pasqyron gjendje bashkëkohore leksikore në komunikimin e zakonshëm të këtij komuniteti.

Shfaqja e marrëdhënieve komplekse sociolinguistike është karakteristikë që ndeshet në diasporën migratore shqiptare, si rezultat i situatës në kontakt të dygjuhësisë (bilinguizmit) ose shumëgjuhësisë. Referuar arealit gjuhësor të Zarës, kjo situatë ka prodhuar një dialekt të ri (mbidialekt), i cili del si vazhdueshmëri e dialektit gegë, por që rezulton i ndryshëm nga çdo dialekt tjetër i përdorur në tokën mëmë. Nëse vëzhgojmë nga afër strukturën gjuhësore të të folmes arbëreshe të Zarës, vërejmë, në çdo nivel të analizës, një konfiguracion të artikuluar, që është rezultat i ndikimeve të shumta nga sisteme të tjera gjuhësore me të cilët arbëreshët kanë qenë në kontakt para dhe pas emigrimit në Zarë të Kroacisë.

[1] V, Proko, J. Kume, *The Literary Lexicon in the two Arbanasi–Croatian Dictionaries of Kruno Krstić (1987) and Maximiljana Barančić (2021): A Comparative Approach,* në: Konferenca Shkencore "Arbanasi – Identiteti, Kultura dhe Kontributi i Komunitetit" ("Arbanasi - Identitet, Kultura i Doprinos Zajednice"), organizuar nga Universiteti i Zarës në Kroaci, më 20 tetor 2026 (në proces botimi).

Ashtu, sikurse autorja e Fjalorit Arbëresh-Kroatisht M. Barančić pohon në *Parathënien* e veprës së saj, se *ky variacion gjuhësor i shqipes nuk do të kishte mbijetuar, nëse nuk do të kishte qenë nën çatinë e gjuhëve të komuniteteve më të shumta, si italishtja dhe kroatishtja.* Në nivelin leksikor, shqipja e sotme e Zarës nuk njeh shumë fjalë të reja të shqipes standarde, kështu boshllëkun leksikor të krijuar gjatë komunikimit të përditshëm, e kanë plotësuar shumë njësi leksikore të huazuar nga kroatishtja dhe italishtja, pjesë e lemave të makrostrukturës në veprat përkatëse.

Kjo situatë shekullore me kontakte të ngushta gjuhësore karakterizohet nga *code-mixing*[2] dhe *code-switching*[3], që kanë qenë objekt studimi në terren përkatësisht për të folmet arbëreshe të Italisë nga studiuesi Leonardo M. Savoia[4]. Ky koncept teorik e gjen veten edhe në situatën e njëjtë sociolinguistike të enklavës së vogël të Zarës. Kjo vihet re dukshëm në makrostrukturën e fjalorëve, ku lema (priora) (njësi leksikore përfaqësuese që ndodhet në krahun e majtë), e cila është e pasqyruar për kategorinë gramatikore *emër* në trajtën e njëjësit të pashquar dhe në kllapa jepet mbaresa e tyre në trajtën e shquar, duke u shoqëruar me specifikimin e kategorisë gramatikore p.sh.: *baçavâr (-ari)* m. "fuçibërës, vozgar, vozaxhi". *Baçvâr* me bazë leksikore nga gjuha kroate *bačvar* dhe mbaresa trajtëformuese e shquarsisë së shqipes *-i* (gjinia mashkullore, trajta e shquar). Po ashtu lema *bandîr (-a)* me bazë leksikore të huazuar nga gjuha italiane + mbaresë të shquarsisë së shqipes (*-a*) - gjinia femërore, trajta e shquar. Njësia leksikore *bandir* ka ruajtur gjininë femëror të fjalës italiane (*la bandiera*), sepse sipas rregullave fjalëformuese të shqipes duhet të ishte *bandir-i* dhe jo *bandir-a,* sikurse përdoret në këtë të folme. Sipas rregullave gramatikore të shqipes, bashkëtingëllorja fundore e fjalës në trajtën e pashquar "r" kërkon pas trajtën e shquar të gjinisë mashkullore, pra mbaresën *-i* dhe jo *-a*. E njëjta gjë vlen edhe për lemën me bazë leksikore nga gjuha italiane: *balônç (-a)* f. "kandari, terezia për matje". Vlen për t'u theksuar, se gjatë vëzhgimeve të vëmendshme të lemave në makrosistemin e veprave, vihet re një karakteristikë fonetiko-morfologjike dalluese për këtë varietet gjuhësor, ku *-ë*-ja fundore e fjalëve të gjinisë femëore, trajta e pashquar ka humbur si koncept drejtshkrimor dhe fonetik, me siguri tipar ky i izolimit gjuhësor dhe i përzierjes së fortë gjuhësore "code mixing", p.sh.: *buz-a* dhe jo *buzë-a*; *bes-a* dhe jo *besë-a* sikurse është në shqipes standarde. Po ashtu, nuk ruhet trajta e shquar e emrave të gjinisë femërore kur ato në trajtën e pashquar përfundojnë me zanoren *-e* p.sh.: *bê-a* dhe jo *be-ja*;

Foljet jepen në mënyrën e paskajores së gegërishtes, përgjithësisht për zgjedhimin e parë me prapashtesën *-ua*, që në shqipen standarde korrespondon me mbaresën *-j* për foljet me temë në zanore p.sh.: *ambëlzûa (me)* fol. "ëmblësoj, me ëmbëlsuar"; *ankua (me)* fol. "ankohem, me u ankuar"; *arûa (me)* fol. "harroj, me u harruar"; *bardh (ma, m'u)* fol. "zbardhoj, me zbardhur"; *benkûa (me)* fol. "bekoj, me bekuar, me uruar"; *bîr (me, m'u)* fol. "humbas, me humbur"; *badât (me)* fol. "shikoj, me përfill, me marr parasysh" etj.

Po ashtu edhe mbiemrat e nyjshëm sipas trajtës morfologjike të shqipes p.sh.: *benkûom (i, e, të)* mb. "i bekuar, i uruar"; *bashtardâtum (i, e, të)* mb. "bastard"; *begenîtum (i, e, të)* mb. "i autorizuar, i miratuar, i lejuar"; *bîrum (i, e, të)* mb. "i humbur"; *akullûom (i, e, të)* mb. "i ngrirë"; *âmbël (i, e, të)* mb. "i ëmbël"; *ârit (i, e, të)* mb. "i artë" etj.

Në mënyrë të veçantë në veprën e M. Barančić gjallojnë dendur italianizma, kroatizma, si dhe njësi ndërkombëtare ose huazime nga gjuha gjermane, si p.sh.: it. *amante* "" tek Fjalori M. Barančić; it. *abandonat (me, m'u)* fol., it. *abandonatum (i, e, të)* mb.; it. *abortirat (me)* fol.; it. *apena* ndajf. "sapo"; it. *arivat*; it. *arkobalen*; it. *akomoduat (me, m'u)* fol.; it. *aragôšt*, it. *balônč (-a);* it. *barbjèr (-êri);* it. *bevônd (-a);* it *bòrš*, it. *pinèl (-êli);* it. *dizhgrôcje (-ja)* "fatkeqësi"; *Befâna*; it. *pašticôd (-a)* "lloj ushqimi me mish dhe erëza pikante"; gjerm. *apotèk (-eka)*

[2] Referuar Enciclopedia dell'italiano Treccani, www.treccani.it.
[3] Referuar Enciclopedia dell'italiano Treccani, www.treccani.it.
[4] L. Savoia, *Varazione e mescolanza linguistica nei sistemi arbëreshë: code-mixing, prestiti e convergenza in condizioni di bilinguismo. Strutture gerarchiche e ricorsività nelle lingue naturali (2005-2007)* dhe *Per una mappa dei tratti e delle categorie grammaticali (2007-2009),* PRIN, financuar nga MIUR.

"farmaci" nga gjermanishtja; fr. *parket (-èti)*; fr. *parôd (-a)* "paradë"; fr. *bukèt (-êti) m.* "buqetë, tufë lulesh" (bukêtat). Disa prej këtyre italianizmave i ndeshim edhe tek Fjalori i K.Krstić - it. *bashtardâtum (i, e, të)* mb.; *bandîr (-a)* flamur; *kuntentât (me, m'u)* fol. "për të kënaqur"; *kuntènt (i, e)* mb. "i kënaqur" etj. Pjesë e kësaj interference leksikore janë edhe huazimet e drejtpërdrejta leksikore nga gjuha kroate, si p.sh.: *çestitât (me)* fol. "uroj, me uruar" (kroat. čestitati); *dimnjok (-u)* m. "oxhak" (kroat. dimnjak); *divèr (-êri)* "kunat" (kroat. djever); *bunâc (-a)* f. "det i qetë, qetësi deti" (kroat. bunaca); *beden (-i)* m. "mur i trashë, fortifikatë" që gjendet dhe në gjuhën kroate *bedem*, por me origjinë nga gjuha arabe etj.

Njësi ndërkombëtare dhe koncepte të reja që nuk janë në *Fjalorin* e K. Krstić, por që është tipar tregues i leksikut bashkëkohor tek *Fjalor Arbënisht-Kroatisht* i M. Barančić, si p.sh.: *aeroport (-i)*; *adenci (-ija)* për agjenci; *adrês (-a)* për adresë; *bank (-a)*, *bankier (-i)*; *balerîn (-a); bikîn (-i); bòks (-i); boksât (me)* fol.; *butîg (-a)* për dyqan, *butîgèr (-i)* për shitës; *vikend (-i)* për fundjavë; *turist (-i)* për turist; *turnêj (-a)* për turne; *hôb (-i)* etj.

Në të dy fjalorët, lema përfaqësuese është njëfjalëshe me përjashtim të ndonjë toponimi dygjymtyrësh si p.sh.: *Bira e Çepërit, Bregdeti i Joviçit, Bregu i Sokos* apo ndonjë thënieje si *atush motit* me kuptimin "prej atëhere, prej asaj kohe" etj.

Po ashtu, element objektiv i studimit tonë lidhur me makrostrukturën përkatëse është evidentimi i njësive leksikore dhe shprehjeve të hershme dialektore të trashëguar nga gjuha e origjinës (referuar veçanërisht *Fjalorit të të folmes së arbëneshëve të Zarës*, K. Krstić disa prej të cilave kanë mbijetuar edhe në ligjërimin e ditëve të sotme dhe i gjejmë të përfshira në korpusin leksikor të *Fjalorit Arbënisht-Kroatisht* të M. Barančić), si p.sh.: *adet (-eti)* "traditë"; *afam (-ami)* "alivanosje" (edhe tek M. Barančić (2021); *asër* (-asra) "para, të holla" (edhe tek M. Barančić (2021); mungesa e fonemës *h* nistore tek fjalët e shqipes së kësaj të folmeje si p.sh.: *aje (aja)* për "haje" (edhe tek M. B (2021) sipas fonologjisë së shqipes së sotme "haje"-"ushqim"; *ajn (-i, a)* për *hajn* - "cub, plaçkitës"; *ardhi (-a)* për *hardhi rrushi*; *ardhuc (-uca)* për hardhucë; *arç* (arçi, arçnje, arçnjet) për "harxhimet, shpenzimet" (edhe tek M. Barančić (2021); *ak (-aku)* për *hak-u*; *ap (me)* për hap; *bukli (-a)* f. "gotë prej druri për të mbajtur verë", mund të jetë njësi tipike e këtij varietetit historik etj. Tipari konservativ i trajtave të vjetra të shqipes shfaqet edhe në ruajtjen e gjinisë asnjanëse të emrave prejpjesorë si p.sh.: *birum (të)* asnj. "humbje"; *bërtitum (të)* asnj. "britmë"; *dalum (të)* asnj. "dalje, të dalurit"; drill (te) asnj. "pastërtia"; *dèrdhum (të)* asnj. "barkqitje, jashtëqitje"; *dôum (të)* asnj. "ndarje, divorc"; *rît (të)* asnj. "rini, rinia", *rîtum (të)* asnj. "rritje, shtat, gjatësi trupi" etj.

Gjithashtu, makrosistemi i korpusrit përkatës leksikor përmban fjalëforma mjaft interesante me bërthamë leksikore vendëse, të veshura me *para* dhe *prapashtesa* tipike të të folmes përkatëse për të emëruar nuanca të imta kuptimore, si p.sh.:

brêshën (-shni) m. "breshër"
breshnî (-ia) f. "breshër i imët, i hollë"
breshnik (-iku) m. "breshër i hollë" (*breshën* "breshër" + ik) etj.

Po ashtu, njësitë *përsŷ (me)* fol., me sinonim *mbërsye (me)* mbajnë kuptimin "për të vëzhguar, ngul sytë në diçka" janë fjalëforma me parashtesat *për-* dhe *mbër-* dhe bazë leksikore fjalën *sy*, fjalëforma jo të pranishme në shqipen standarde. Po ashtu, kompozitat leksikore: *bythmbrâpa* ndajf. "nga mbrapa" (byth + mbrapa) dy pjesë që tregojnë pjesën e pasme të diçkaje, që përdoret me përforcim të fjalës "byth"; si dhe njësi leksikore me përngjitje, tipike të këtij varieteti si p.sh.: *përmidôr (-a)* f. "shpina, kurrizi i dorës" (për + mbi + dorë); *përmjedum (i, e)* mb. "i mesëm" (për + mjedum); *dogjonîtena* ose *dohjonitena* ndajf. "dëgjo diçka, ndonjë gjë, diçka ka me ndodh"; *dokunôtena* ndajf. "diku, ndokund"; *asonôtje* ndajf. "atë mëngjes" (*aso* "atë" + *notje* "mëngjes", ndoshta ky kuptim ruhet nga shqipja e hershme, pasi e ndeshim edhe tek arbëreshet e Italisë jugore *menàt-a* "mëngjes (mattina)", *menàtet* ndajf. "në mëngjes" (shih. P.

Scutari, f. 55)[5]; *bôt* ndajf., përdoret në fjalë të përngjitura të ndërlikuara në vend të fjalës "herë", si p.sh.: *njibot, osobot, sobot* (*njizet bot e kam lut* "njëzet herë e kam lutur") etj.

Nga sa shohim edhe nga shembujt e dhënë, fjalëformimi ka të bëjë me ri/konceptim strukturor të gjuhës, pra është gjeologjia e saj dhe si i tillë e ka vendin në fjalor ku bëjnë pjesë fjalëforma tipike të këtij areali me *para* dhe *prapashtezim, kompozim,* ku lehtësisht arrijmë të shquajmë elementin dialektor (variacionin fonetik të dialektit apo të folmes përkatëse p.sh.: shfaqja e q në ç: *çërshî* për qershi*, çìell* për qiell*;* në disa njësi leksikore është transformuar nga *a* në *o* si p.sh.: *bôr* për bar; *bôrk* për bark. Gjithashtu, në këtë të folme mungojnë disa shkronja si p.sh.: shkronja *h* tek fjalët: *ardhuc* për hardhucë, *ap* për hap, *ardhi* për hardhi, *ajdùk* për hajdut; rr në r si p.sh.: *ràth* për rreth, *rjêp* për rrjep, *rizikûoshim (i, e, të)* për "i rrezikshëm"; ku për çdo rast konkret autorët nuk kursejnë të ilustrojnë me thënie a idioma të vjela nga ligjërimi i zakonshëm për të evidentuar njëkohësisht jetën e fjalës së zakonshme të këtij *areali gjeografik.*
Nga tërësia e fjalësit të shqyrtuar, tërheq vëmendje të veçantë një kategori e emrave, që në trajtën e pashquar përfundojnë me zanoren *-e-,* për shquarsinë e të cilave i bashkëlidhet mbaresa *-ea* në vend të mbaresave *-a* ose *-ja* të gjuhës shqipe p.sh.: *âne (-ea)* f. "e hënë"; *bërbële (-ea)* f. "gagaç, belban"; *çîzme (-ea)* f. "çizme"; *çôshe (-ea)* f. "qoshe, kënd"; *delme (-ea)* f. "dhen-t, delet"; *gastâre (-ea)* f. "gotë"; *gâle (-ea)* f. "dele e zezë"; *fâçe (-ea)* f. "fytyrë"; *furtêre (-ea)* f. "tavë"; *bençûre (-ea)* f. "peshçure"; *çizme (-ea)* f. "çizme"; *çoshe (-ea)* f. "qoshet, këndet"; *delme (-ea)* f. dele etj. Kjo trajtë morfologjike arkaike, element dallues morfologjik i greqishtes mesjetare, gjendet dendur jo vetëm në këtë varietet gjuhësor, por edhe tek disa të folme tek arbëreshët e Italisë jugore, si tek e folmja konservative e Shën Kostantinit (p.sh.: *ljulje-ljea, bishtje-tjea, faqe-qea, nuse-a, cakul-lea, denxere-rea, hjirovolje-ljea, kalistire-rea* etj.). Këto varietete të izoluara gjuhësore vazhdojnë të ruajnë mbaresën e vjetër greke *-èa*, ndërkaq kur në gr. e re në fillim të shek. XIV, kjo trajtë e vjetër është zëvendësuar me trajtën moderne *-ia*. Ky konstatim i një rëndësie të veçantë për gjuhësinë krahasuese historike, dëshmon se kjo trajtë ka depërtuar në të folmet përkatëse nga elementi grek i gjuhës shqipe, d.m.th. përpara shek. XIII, ku sikurse e dimë, popullata shqiptare nisi zbarkimin për në Greqi shumë kohë më parë sesa popullata e mërguar të vendosej në Kroaci, Italinë jugore dhe në Sicili[6].
Në lidhje me volumin e lemave në veprat e marra në studim, duke ballafaquar vetëm dy shkronjat e para të fjalorëve (A dhe B), është evidentuar se, numri i njësive leksikore të përcjella në Fjalorin e M. Barančić është më i madh, afërsisht 428 njësi, në raport me 374 njësi të pasqyruara në Fjalorin e K. Krstić. Kjo shpjegohet me faktin se, të dy fjalorët janë vazhdimi i lidhjes logjike për të studiuar dhe ruajtur gjuhën shqipe, i cili regjistron të gjithë tiparet thelbësore të të folurit të sotëm, por edhe atë që është zhdukur nga përdorimi ose përdoret më rrallë sot. Falë këtyre fjalorëve, idioma shqipe sot mund të studiohet më mirë. Kjo rritje leksikore në të folurën e përditshme të shqiptarëve të Zarës lidhet, gjithashtu, me përdorimin më të madh të italianizma dhe kroatizma, pasi kjo ka qenë e vetmja mënyrë që ata të komunikojnë në shqip. Shqipja e kësaj të folmeje, e izoluar nga gjuha mëmë e origjinës, nuk njeh shumë fjalë të reja, kështu që përdoren fjalë kroate dhe italiane, të cilave u shtohen mbaresa shqipe.
Lidhur me sa u tha, korpusi leksikor i komunikimit të përditshëm, në fjalorët përkatës, pasqyron jetën e kësaj të folmeje, që me vendosjen në vendndodhjen e re e deri me zhvillimet më të fundit fonetiko-morfologjike dhe leksiko-semantike të njësive leksikore themelore gjatë ditëve të sotme. Gjatë analizës së makrostrukturës së veprave përkatëse leksikografike, evidentohen qartazi, kriteret dhe objektivat e veprave përkatëse, sikurse tipari paradigmatik i çerdhes së

[5] P. Scutari, "Dizionario arbëresh di San Costantino Albanese", Presentazone di F. Altimari, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia, 2010, f. 55.
[6] T. Johalas, *Considerazioni sull'elemento greco nell'arbëresh,* "I dialetti italo-albanesi, Studi linguistici e socio-culturali sulle comunitá arbëreshe", a cura di F. Altimari - L. M. Savoia, 1994, f. 141.

ngushtë leksikore i lemës përfaqësuese / temës bazë fjalëformuese (gjë që do të thotë, mungesë derivimi paradigmatik me prapashtesa, kompozime me përçim nga kategoria gramatikore e emrit, mbiemrit, foljes (forma veprore dhe joveprore) e deri tek ndajfolja etj., sikurse ndeshim natyrshëm në fjalorët shpjegues normativ të një gjuhe ose në fjalorët dygjuhësh etj. Çerdhe disi më e zgjeruar leksikore pasqyrohet në veprën e K. Krstić, pasi kjo vepër përmban një numër shumë të madh fjalësh shqipe, gjurmimi i të cilave ka qenë dhe qëllimi kryesor i autorit. Ky tipar leksikografik shënohet me rrënjën katrore [*tal*.] (italisht) pas kategorisë gramatikore të lemës përfaqësuse, si p.sh.:

šànk (šânku) m. r. [*njem.]* šank (dugi stol u gostionci i sl., s kojeg se poslužuje piće) ... "huazim nga gjermanishtja [*njem.]* "bar (një tavolinë e gjatë në një tavernë në të cilën shërbehen pije)", f. 125.

Ndërkaq, në *Fjalorin arbërisht-kroatisht* të M. Barančić, lema "bash" nuk ka ndjekur zhvillimet leksiko-semantike, edhe pse autorja gjatë hartimit të veprës është mbështetur në veprën e K. Krstić. Lema përkatëse pasqyrohet vetëm me një njësi leksikore, lemën përfaqësuese: *bâšk* ndajf. "së bashku", f. 8.

Mikrostruktura e këtyre veprave leksikografike është ndërtim i strukturuar i semës sipas tipologjisë hartuese të çdo vepër, që do të thotë *kuptimi ose koncepeti bazë* i lemës përfaqësuese. Lema përfaqësuese është pjesë e makrostrukturës, ndërsa sema e saj, përmbajtja kuptimore, që merret në analizë dyfishe: shpjegim + ilustrim, pozicionuar në të djathtë të lemës përfaqësuese (lema priora në të majtë të semës) është mikrostruktura e njësisë leksikore përkatëse. Në mikrostrukturë, me sistem nënkuptohet (i) një rrjet pozicionesh në brendësi të të njëjtës fushë semantike dhe (ii) një rrjetë pozicionesh në brendësi të disa fushave semantike. Vepra e K. Krstić në mikrostrukturën e saj nuk shpërndahet në degëzimin e zhvillimeve semantike të lemës, ku autori brenda një shpjegimi semantik përcjell semën denotative me sinonimi dhe herë-herë zhvillimin konotativ të saj, si p.sh.: *fâçe (-ea)* f. "fytyra, <u>turpi</u>" – *aj' sht po façe* "ai është i pa fytyrë, i pa turp, faqezi", *façe e zi – mos e nxi façen fisit* "mos ia nxi faqen (fytyrën) fisit, mos e turpëro"(K. K., f. 108). Gjatë analizës së semave, autori mundohet të japë sinoniminë e plotë të lemës përfaqësuese, duke iu afruar polisemisë si p.sh.:

badënj (-nji) m. "fuçi, vozgë"; *badill (-ili)* m. "lopatë, qyrek, tërplotë";
barabàr ndajf. "paralelisht, krahas, dorë për dore" etj.

Ndërkaq, vepra e M. Barančić jep barasvlerësin e lemës në kroatisht, dhe sinonimin e lemës në shqip dhe disi më rrallë ndalet tek vargu sinonimik p.sh.: *fâče (-ea) ž.r.* lice, obraz; mn. fâčet; fâčea j'o e mblûom me prišta ... (f. 35).

Tipar i përbashkët i të dy veprave leksikografike është *ilustrimi me thënie apo shprehje frazeologjike* të vjela nga gjuha e përditshme apo nga letërsia popullore (këngë, tregime, fjalë të urta etj), të cilat zakonisht renditen pas shpjegimit semantik të autorit p.sh.:

Tek K. Krstić njësia *drapën (drapni)* m. drapër, <u>mbidh sht si drapni "është cakur (deformuar) si drapër"</u> = m. *srp; skvrčio se kao srp. f. 98.*

Tek M. Barančić njësia *drâpën (drâpni) m.r.* srp (za žetvu žita); *mn.* drâpnjet; *var.* drâpenj (drâpnji) *mn.* drâpnjet; *sin.* fačâr (-i) *mn.* fačârt; sërp (-i) sërpat; kosòr (-ôri) *mn.* kosòrt etj.

Homonimia është një tipar që ndeshet shpesh në faqet e fjalorëve, shpesh duke shënuar risi kuptimore dalluese nga një vepër të tjetra, por që funksionojnë në dobi të leksikut, si dy pjesë të së njëjtës, që plotësojnë tërësinë leksiko-kuptimore të korpusit të këaj të folmeje. Le ta ilustrojmë me disa shembuj:

1. Tek K. Krstić: bâk (bâku)$_1$ m. "dem i ri, mëzat, derr për mbarsim", f. 70.
   bâk (bâku)$_2$ m. "një lloj kafshe mitike, kuçedër"

Tek fjalori i M. Barančić jepet kuptimi i parë dhe jo lidhja homonimike e lemës si më lart: bâk (bâku) *m.r.* bik; *mn.* bâkat; var. bìk (bîku) mn. bîkat - ("demi sh. bakat") f. 7.

2. Njësia leksikore <u>*bôkul (-i)*</u> shfaqet në homonimi vetëm tek M. Barančić, si p.sh.:
   bôkul (-i)$_1$ *m.r.* uvojak; *mn.* lôkulat; *sin.* lôkën (-kna) *mn.* lôknat; ric (rîca) mn. rîcat; *bicet jèm i kân pât bôkulat kûr kàn kên të vôgël "*fëmijët e mi kishin kaçurrela kur kanë qenë të vegjël".
   bôkul (-i)$_2$ *m.r.* klin, vretence "pyk"; *mn.* bôkulat; *sin.* kunj (kûnji) *mn.* kunjat; klîn (-i) *mn.* klînat *mn.* pôlš (-i) *mn.* pôlšat

Duhet nënvizuar se, në fjalore takohen fjalë të shqipes së sotme, por me kuptime të tjera, si p.sh. *fang*-u m. për "baltë"; *gogël* për "topth"; *guriç* për "gur i vogël, gurth"; *përpizë* për *"*ezofag"; folja *me gurua* "muroj me gurë"; *përmidorë* për "shpina e dorës, kurrizi i dorës"; *kulaç (-âçi)* m. për "ëmblësirë, pastë"; *kulet (-a)* f. për "xhep"; *kull (-a)* f. për "ndërtesë dykatëshe"; *abêrje (-ja)* f. "zhurmë, shqetësim"; *bâb (-a)* f. "gjyshe"; ashtu edhe thënia *terezia për matje* për "kandar, peshore". Po ashtu, njësia *notje*-tja për "mëngjes-i", ndajfolja e kohës *në notje* (në natje, në mëngjes) etj. Sipas studiuesit A. Zymberi në kumtimin V*ështrim leksikor i fjalorit të së folmes së arbneshëve të Zarës të dr. Kruno Kërstiqit*, mbajtur në SNGJLKSH të Prishtinës, më 1989[7], folja *me kaptua* përdoret me kuptimin "perëndoj", ndërsa emri *kaptim* përdoret me kuptimin "perëndim", ndërsa në shqipe ka kuptimin "kapërcim". Interesante është fjala *lemzë* për "lyth", *bradavica* -serbokroatisht.

Meqë u fokusuam tek leksiku i të folmes arbëreshe të Zarës merr rëndësi të veçantë klasifikimi i disa prej njësive sipas fushave kryesore tematike, ku nuk kemi të bëjmë me terma të mirëfilltë, por edhe me njësi të leksikut tematik ose dituror, që shënojnë vlerë pasuruese leksiko-semantiko/konceptuale edhe në fusha të veçanta përdorimi.

Disa prej fushave kryesore semantike ku mbështetet korpusi leksikor janë:

1. Shtëpia, orenditë shtëpiake: *çeri* (-ini) m. "shishe vaji"; *dôt* (-*a*) f. "paja"; *barôk* (-*a*) f. "fuçi e drunjtë"; *baùll* (-*i*) m. "arkë e madhe" etj.
2. Vegla artizanale, bujqësore dhe baritore: *badil* (-*îli*) m. "lopatë, qyrek"; *balonc* (-*a*) f. "kandar"; batòç (-i) m "gurthyes, çekan i madh" etj.
3. Pjesë të trupit: *berikàt* (-*i*) m. "fyt, gabzerr"; *brùl* (-*ùli*) "bërryl"; *buz* (-*a*) f.; *çaf* (-*a*) f. "qafë" etj.
4. Ushqime, pije dhe ëmbëlsira: *buculàj* (-*aji*) m. "lloj ëmbëlsire"; bûk (-*a*) f.; çimòr "elb, bukë elbi"; *butir* (-*iri*) m. "tëlyen, gjalpë"; *bëzhôll* (-*a*) f. "bërxollë" etj.
5. Jeta shoqërore, kulturore dhe civile: *beriçèt* (-*eti*) m. "fati, uratë"; *bes* (-*a*) "fjala e dhënë"; *bogatî* (-*a*) f. "pasuri" etj.
6. Profesione dhe zeje: *baçvàr* (-*ari*) m. "fuçibërës"; *barbjèr* (-*i*) m. "berber" etj.
7. Bimë dhe pemë: *bërbèç* (-*eçi*) m. "lloj barishteje, bime"; *borovîn* (-*a*) f. "pishë, pishnaj" etj.
8. Peizazh, terren, qytet: *brèg* (-*êgu*) m. "breg, kodër"; *bregdèt* (-*i*) etj.
9. Fe, bestytni dhe folklor: *dèç* m. "djall" etj.
10. Familja dhe farefisnia: gjeverush (-usha) f. "kunatë"; konshî (-a) f. "komshi, fqinjë"; dôum (të) asnj. "ndarje, divorc"; bâb(-a) f. "gjyshe"; gjysh (-i) m. "gjysh" etj.
11. Zogj dhe kafshë: *dragulîc* (-*a*) f. "një lloj zogu, shpendi"; *babaùk* (-*uku*) m. "merimangë"; *babêl*-i (-*êli*) "kukuvajkë"; *bêshtje (-tja*) f. "kafshë"; *boll* (-*a*) f. "gjarpër"; *brungjàl* (-*àla*) f. "lloj peshku"; *bërshlàn* (-*i*) m. "urith"; *bërbil* (-*ili*) m. "bilbil"; *buèll* (-*elli*) m. "dem", *bubarec* (-*i*) m. "milingonë, mizë dheu" etj.

[7] A. Zymberi, V*ështrim leksikor i fjalorit të së folmes së arbneshëve të Zarës të dr. Kruno Kërstiqit*, SNGJLKSH/14, Prishtinë 1989, f. 123-128.

12. Fenomene natyrore, mjedise: *babinpâs (-i*) m. “ylberi”; *bôr* (-*a*)1 f. “stuhi, veri”; *bôr* (-a) f. “bora, rreshje atmosferike” etj.
13. Mallra, metale dhe minerale: *bronxî* (-*îni*) m. “kusi e madhe” etj.

Organizimi sipas fushave semantike bën të mundur rindërtimin e aspekteve domethënëse të jetës së përditshme, të veprimtarive ekonomike, të traditave dhe të përvojës kulturore të bashkësisë arbëreshe të Zarës.

Përfundime

Analiza krahasuese e fjalorëve të Kruno Krstić-it dhe Maksimiljana Barančić-it bën të mundur evidentimin e vlerës gjuhësore, historike dhe social-kulturore të së folmes arbëreshe të Zarës, si dhe rëndësinë e të dyja veprave për dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë së saj leksikore dhe verteton se struktura gramatikore shqipe bashkëjeton me një leksik të pasuruar nga huazime nga kroatishtja, italishtja dhe gjuhë të tjera. Këto dukuri nuk duhet të konsiderohen vetëm si shenja të humbjes gjuhësore, por edhe si dëshmi të dinamikave historike, kulturore dhe sociolinguistike që kanë karakterizuar bashkësinë arbëreshe të Zarës. Të dy fjalorët, edhe pse paraqesin dallime strukturore dhe metodologjike, përbëjnë mjete plotësuese për studimin e kësaj varieteti gjuhësor. Puna e Krstić-it dokumenton një trashëgimi të rëndësishme formash arkaike, strukturash morfologjike dhe familjesh leksikore, ndërsa ajo e Barančić-it ofron një dëshmi të së folmes në një fazë më të vonë, duke regjistruar edhe risitë dhe transformimet e prodhuara nga kontaktet gjuhësore. Rezultatet e paraqitura konfirmojnë, se dokumentimi leksikografik nuk ka vetëm një funksion përshkrues, por përfaqëson edhe një mjet themelor për ruajtjen e kujtesës gjuhësore dhe kulturore të pakicave. Në këtë këndvështrim, zgjerimi i kërkimeve krahasuese dhe digjitalizimi i trashëgimisë leksikore mund të favorizojnë forma të reja studimi, konsultimi dhe vlerësimi të të folmes arbëneshe të Zarës. Të dy fjalorët përbëjnë, pra, jo vetëm një dëshmi të historisë gjuhësore të arbëneshëve të Zarës, por edhe një bazë thelbësore për nismat e ardhshme të dokumentimit dhe të rigjallërimit të arbnishtes.

Referencat

[1]. Ajeti, I. (1985). “Zhvillimi historik i të folmes gege të arbneshëve të Zarës”, në: Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II, Prishtinë.

[2]. Ajeti, I. (1987). “Ndihmesë e re në fushën e leksikologjisë shqiptare (Kruno Krstić, Rječnik govora zadarskih Arbanasa. Izdanija Mjesne Zajednice Arbanasi, Knj. 2, Zadar, , 135 f.”), në: “Gjuha shqipe” 6/1987, 3, f. 66-72.

[3]. Barančić, M. (2021). "Arbanaško - Hrvatski rječnik s gramatikom- "Hrvatski - Arbanaško rječnik s gramatikom.

[4]. Barančić, M. (2023). “*Croatian–Arbanasi Dictionary and Arbanasi–Croatian Dictionary with Grammar”*, Universiteti i Prishtinës: Fakulteti i Filologjisë, Seminari [41] Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë.

[5]. Barančić, M. (2024). Zadar arbanasi speech-preservation of cultural and heritage identity. Universiteti i Prishtinës: Fakulteti i Filologjisë, Seminari [42] Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë.

[6]. Boriçi, H. & Lila, J. (2024). *"Histori e Shtypit Arbëresh nga Zanafilla deri në Ditët e Sotme"*, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Tiranë.

[7]. Elsie, R. (2001/2005). *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture*/Leksiku i kulturës popullore shqiptare. New York University Press, Washington Square, New York/Skanderbeg books. Tiranë.

[8]. Erber, T. (1883). *La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara, cenni storici,* “G. Flori”. Ragusa.

[9]. Erber, T. (1997). *Kolonia shqiptare e Arbëneshit pranë Zarës*. Bashkësia Shqiptare në Republikën e Kroacisë. Zagreb, fq. 1-114.

[10]. Johalas, T. (1994). *Considerazioni sull'elemento greco nell'arbëresh,* “I dialetti italo-albanesi, Studi linguistici e socio-culturali sulle comunitá arbëreshe”, a cura di F. Altimari - L. M. Savoia.

[11]. Krstić, K. (1968). *Dyndja e arbëreshëve në Zarë*, “Rilindja”, Prishtinë, f. 169-194.

[12]. Krstić, K. (1987). *Rjecňik Govora Zadarških Arbanasa*. Mjesna Zajednica Arbanasi. (*Fjalor i të folmes së arbëneshëve të Zarës*. Bashkësia Lokale Arbanasi), knj. 2, Zadar, str. 134.
[13]. Krstić, K. (1988). *Doseljenje Arbanasa u Zadar*. Mjesna Zajednica Arbanasi, (*Vendosja e arbëneshëve në Zarë*, Bashkësia Lokale Arbanasi), knj. 2, Zadar, str. 1-66.
[14]. Neziri, Z. & Stipčević. A. (1997). *Historia dhe bibliografia e arbëreshëve të Zarës*, Shkup, f. 61-128.
[15]. Neziri, Z. (2021). "Gjuha arbëneshe është e "rrezikuar"", në: "Continuum"- *Revistë e studimeve arbëreshe*, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, nr. 1, 2020–2021. Tiranë, f. 79-88.
[16]. Neziri, Z. (2022). "Arbëneshët e Zarës përgjatë shekullit XIX", në: *Gjendja aktuale e Studimeve Arbëreshe – Aktet e Kuvendit të Parë të Studimeve Arbëreshe*, 27-28 shtator 2021, QSPA, Tiranë, f. 88-105.
[17]. Proko, V. (2025). *Kruno Krstiq dhe Fjalor (Arbërisht-Shqip-Kroatisht)–Rjecňik (Arbanaški-Albanski-Hrvatski)*: Konferenca shkencore ndërkombëtare "Figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe vise të tjera shqiptare", 25, 26 e 27 tetor 2024 Preshevë. Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore e Luginës së Preshevës. Prishtinë, f. 97-108.
[18]. Proko, V. & Kume, J. (2026). *The Literary Lexicon in the two Arbanasi–Croatian Dictionaries of Kruno Krstić (1987) and Maximiljana Barančić (2021): A Comparative Approach,* në: Konferenca Shkencore "Arbanasi – Identiteti, Kultura dhe Kontributi i Komunitetit" ("Arbanasi - Identitet, Kultura i Doprinos Zajednice"), organizuar nga Universiteti i Zarës në Kroaci, më 20 tetor 2026 (në proces botimi).
[19]. Savoia, L. M. *Varazione e mescolanza linguistica nei sistemi arbëreshë: code-mixing, prestiti e convergenza in condizioni di bilinguismo* (PRIN) MIUR. *Strutture gerarchiche e ricorsività nelle lingue naturali (2005-2007)* dhe *Per una mappa dei tratti e delle categorie grammaticali (2007-2009).*
[20]. Scutari, P. (2010). *Dizionario arbëresh di San Costantino Albanese*, Presentazone di F. Altimari, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia,.
[21]. Stipčević, A. (1977). *Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima*. Povodom 250-godišnjnice doseljenja zadarskih Arbanasa. Zadar.
[22]. Stipčević, A. (1991). "Albanologjia në Kroaci", në: "Gjurmime Abanologjike", Seria e Shkencave Historike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Nr. 21.
[23]. Stipčević, A. (1994). "Interpretime albanologjike", në: "*Flaka e vëllazërimit*", Shkup.
[24]. Stipčević, A. (2009). "Elemente parahistorike në besimet e arbëneshëve të Zarës" në: "*AKTET*" e Institutit Alb-Shkenca, Tiranë-Prishtinë-Shkup., V. III/4, f. 505-509.
[25]. Stipčević, A. (2011). *Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa* (*Kultura tradiconale e Arbëneshëve të Zarës*). Zagreb.
[26]. Stipčević, A. (2012). "Etnogjeneza e shqiptarëve nga Ilirët", në" "*Studime Albanologjike*", Nr. 5, Shkup.
[27]. Stipçeviqi, A. (1988). "Filozof, filolog dhe leksikograf i njohur (Me rastin e vdekjes së dr. Kruno Krstićit)" në: "Gjuha shqipe"/1, IAP, Prishtinë, f. 78-79.
[28]. Shema, I. (2024). *Arbëneshët e Zarës - Shqiptarët e Zarës (Histori, gjuhë, arsim, kulturë, letërsi)*, Zarë.
[29]. Shema, I. "Sintezë shkencore kushtuar kulturës tradicionale të arbëneshëve të Zarës", në: *ExLibris*-Gazetë e përjavshme letrare-kulturore, 19 gusht 2020.
[30]. https://exlibris.al/sinteze-shkencore-kushtuar-kultures-tradicionale-te-arbenesheve-te-zares/
[31]. Topalli, K. (2006). "Për kronologjinë e disa dukurive fonetike në të folmen e Arbëneshëve të Zarës", në: "*Studime filologjike*"/3-4, f. 133-141.
[32]. Zejnullahu, N. "Dr. Kruno Krstiq: Fjalori i të folmes së arbëreshëve të Zarës", në: "*Flaka e Vëllazërimit*", Shkup, 1987.
[33]. Zymberi, A. (1989). V*është*r*im leksikor i fjalorit të së folmes së arbneshëve të Zarës të dr. Kruno Kërstiqit*, SNGJLKSH nr. 14, Prishtinë.
[34]. *Arbëneshët e Zarës. Historia dhe etnoikultura e tyre*. (Materialet e sesionit shkencor mbajtur më 10 tetor 2016. Instituti Albanologjik. Prishtinë 2018.
[35]. Enciclopedia dell'italiano Treccani, www.treccani.it